

EPPC Albania kërkon një **Deputy Finance Manager**, për klientin e saj, kompani e specializuar në menaxhimin e pasurive të paluajtshme në vend dhe rajon.

Përgjegjësitë kryesore:

- Krijon, koordinon dhe monitoron të gjitha raportet që gjeneron departamenti i financës dhe kujdeset që të jenë në përputhje me kërkesat e menaxhimit të shoqërisë;
- Ndihmon drejtuesin e departamentit në zhvillimin dhe zbatimin e strategjive dhe planeve financiare për të arritur qëllimet dhe objektivat financiare të kompanisë;
- Ndjek, rakordon dhe deklaron shpenzimet e zyrave të përfaqësimit Internacional;
- Mbikëqyr operacionet e përditshme kontabël dhe kontrollon në mënyrë të detajuar llogaritë kontabël përpara mbylljes së raportimeve mujore dhe vjetore;
- Përgatit, analizon dhe kontabilizon efektet e IFRS-ve në bazë të standarteve ndërkombëtare;
- Shqyrton periodikisht rrjedhën e punës dhe operacionalitet dhe punon ngushtësisht me drejtuesin e financës në menaxhimin e operacioneve duke automatizuar dhe përmirësuar proceset;
- Zhvillon dhe menaxhon sistemet duke u kujdesur në mirëfunksionimin e tyre. Ndjek zhvillimin dhe përditësimin e tyre në bazë të nevojave të biznesit;
- Ushtron kontrolle të brendshme për të siguruar përputhshmërinë me politikat dhe procedurat e kompanisë, si dhe me kërkesat e auditorëve dhe tatimorëve;
- Analizon dhe ndjek zbatimin e procedurave të departamentit. Bashkëpunon me drejtuesin e departamentit për ndryshimin e procedurave dhe operacioneve ekzistuese të kompanisë;
- Përgatit deklaratimet mujore dhe ndjek pagesat e detyrimeve fiskale brenda afateve të përcaktuara ligjore;
- Përgatit pasqyrat financiare (mujore dhe vjetore) dhe ndjek kontrollet tatimore;
- Asiston në përgatitjen e buxheteve vjetore;
- Përgjigjet dhe ndjek proceset e auditimit të pasqyrave financiare si dhe proceseve të ndryshme të auditimit të brendshëm dhe tatimor;
- Qëndron i përditësuar me rregulloret financiare dhe praktikatat më të mira dhe siguron që aktivitetet financiare të kompanisë të jenë në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret përkatëse;
- Është përgjegjës për interpretimin dhe shpjegimin e legjislacionit fiskal tek punonjësit e departamentit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Të zotërojë diplomë Universiteti në Financë/Kontabilitet. Preferohet një diplomë master ose certifikim profesional;
- **Minimumi 5 vite përvojë në menaxhim financiar, raportim dhe përgatitje të pasqyrave financiare;**
- **Njohuri të thelluara mbi parimet financiare, rregulloret dhe standardet e kontabilitetit;**
- Njohuri shumë të mira të legjislacionit tatimor;
- Aftësi në përdorimin e softuerëve dhe sistemeve financiare, si dhe njohje të mira të sistemit NAVIZION;
- Njohuri të avancuara të paketës Office dhe të analizës së të dhënave;
- Njohuri të mira të gjuhës angleze;
- Aftësi të forta analitike dhe të zgjidhjes së problemeve, i vëmendshëm ndaj detajeve.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutem dërgoni CV-në tuaj në:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm nëqoftëse CV-ja juaj do të kualifikohet.